

VENDIM
Nr.173, datë 13.2.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA GJEPALAJ TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ, të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Gjepalaj të qarkut të Durrësit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 4 (katër), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Gjepalaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULARE PER TRANSFERIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Sipas inventarizimit te pronave te vecanta te tipit,Pyje,Kullota,Livadhe,Shkembore etj)

Instuticioni i Pushtetit Qendror: M.M.P.A.U

Komuna Gjepalaj

Nr. Rendor	Nr. i prones sipas VKM	Emertesa e Ekonomise Pyjore dhe Kullosore (EPK) Shtrirja Gjeografike e EPK	Emertesa e Ngastres end ndodhja (sipas emertes popullore)	Numeri i Ngastres	Destinacioni	Siperfaqja ne ha.	Funkcioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/ Enti me perjegjesi administrative	Institucioni/ Enti Perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	56	Komuna Gjepalaj Fshati Hardhishte	Gjomi rremilleve	144	Pyll prodhues	10	Lende dru zjarri	M.M.P.A.U	D.R.P-K Durres	
2	57	Komuna Gjepalaj Fshati Hardhishte	Gjomi rremilleve	145	Pyll prodhues	3.25	Lende dru zjarri	M.M.P.A.U	D.R.P-K Durres	
3	57	Komuna Gjepalaj Fshati Hardhishte	Gjomi kokomojve	15	Pyll prodhues	7.5	Lende dru zjarri	M.M.P.A.U	D.R.P-K Durres	
4	58	Shijak Maminas Fshati Shetel	Faqja e Shelgut	3	kullote	31.7	kullote fshati	M.M.P.A.U	D.R.P-K Durres	kullota komunale me VKM nr. 700, dt. 23.10.95

Lidhja 1

Lidhja 1

[illegible]